**VENDIM**
**Nr.353, datë 1.6.2004**

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES TË PËRDORË PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE NË MISIONET JASHTË SHTETIT, EDHE NË RASTE AKSIDENTESH NË GRUP**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 pika 3 dhe 19 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes, që, me fondin e vet limit prej 33 435 000 (tridhjetë e tre milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekësh, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë", me INSIG, sh.a.-në, për sigurimin e jetës së ushtarakëve me misione jashtë shtetit, edhe në raste aksidentesh në grup.
2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**